

VENDIM
Nr. 206, datë 7.4.2023

**PËR NGRITJEN E STRUKTURAVE DHE AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE
PËR MENAXHIMIN INDIREKT DHE USHTRIMIN E FUNKSIONEVE, TË
PËRGJEGJËSIVE DHE TË MARRËDHËNIEVE NDËRMJET AUTORITETEVE
DHE STRUKTURAVE TË MENAXHIMIT INDIREKT TË ASISTENCËS SË
BASHKIMIT EVROPIAN, NË KUADËR TË PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN
RURAL TË INSTRUMENTIT PËR ASISTENCËN E PARAANËTARËSIMIT
(IPARD III)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 11, të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPA III, ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për objekt krijimin e strukturave dhe autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin indirekt dhe marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet autoriteteve dhe strukturave për të marrë detyrat e zbatimit të buxhetit (këtej e tutje “menaxhimi indirekt/MI”), për zbatimin e Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit të Bashkimit Evropian (IPA III), në kuadër të programit të zhvillimit rural (IPARD III), sipas përcaktimeve të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, të ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPA III”, dhe të marrëveshjes sektoriale, të ratifikuar me ligjin nr. 97/2022, “Për ratifikimin, të marrëveshjes sektoriale, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të programit për zhvillimin rural të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPARD III)”.

2. Ky vendim siguron që, nën menaxhimin indirekt të programit IPA III, autoriteteve u ngarkohen përgjegjësi për aktivitetet, në lidhje me menaxhimin, zbatimin, kontrollin, mbikëqyrjen, monitorimin, vlerësimin, raportimin, publikimin apo auditimin e programit IPARD III.

II. STRUKTURAT DHE AUTORITETET E MENAXHIMIT INDIREKT

1. Me qëllim menaxhimin, kontrollin, mbikëqyrjen, monitorimin, vlerësimin, raportimin, publikimin dhe auditimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian, në kuadër të programit për zhvillimin rural të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPARD III) 2021–2027, krijohen strukturat dhe autoritetet, si më poshtë vijon:

- a) Koordinatori Kombëtar i IPA-së (KKIPA);
- b) Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA);
- c) Struktura e menaxhimit (SM), përgjegjëse para ZKA-së, e përbërë nga:
 - i. Organi kontabël (OK);
 - ii. Zyra mbështetëse e ZKA-së.
- ç) Autoriteti menaxhues dhe organi i ndërmjetëm, i përbërë nga:

- i. Autoriteti menaxhues IPARD (AM);
 - ii. Agjencia IPARD.
 - d) Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës Financiare të Bashkimit Evropian (AA).
2. Autoritetet mundësojnë ushtrimin e detyrave që shoqërojnë këtë përgjegjësi, duke përfshirë rastet ku nuk ka lidhje hierarkike ndërmjet këtyre dhe organeve pjesëmarrëse në atë aktivitet.
3. Në ushtrimin e këtyre funksioneve, ndërmjet tyre dhe organeve përkatëse, këto autoritete duhet të krijojnë:
- a) marrëdhënie formale të punës;
 - b) një sistem të përshtatshëm për shkëmbimin e informacionit, duke përfshirë të drejtën për të kërkuar informacion dhe të drejtën e aksesit në dokumentacion dhe në staf, gjithashtu, edhe në terren, nëse është e nevojshme;
 - c) standardet që duhen përmbushur dhe procedurat që duhen ndjekur.
4. Të gjitha raportet, vlerësimet dhe dokumentet e tjera, që lidhen me përgatitjen dhe zbatimin e programit të zhvillimit rural (IPARD III), të cilat i dorëzohen Komisionit Evropian (KE), hartohen në gjuhën angleze.

III. KOORDINATORI KOMBËTAR IPA III

1. Koordinatori Kombëtar i IPA-së është drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.
2. KKIPA-ja, si autoritet i menaxhimit të programit IPA III, është struktura homologe e Komisionit Evropian për procesin e përgjithshëm të koordinimit të programimit, monitorimit të zbatimit, vlerësimit dhe raportimit të asistencës IPA III.¹
3. KKIPA-ja përcakton strukturën përgjegjëse mbështetëse në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës për zbatimin e funksioneve të saj. Rolet dhe përgjegjësitë e kësaj strukture, si dhe lidhjet me strukturat e tjera janë të përshkruara, në mënyrë të detajuar, në manualin e procedurave dhe në marrëveshjen operacionale.
4. KKIPA-ja, gjithashtu:
- a) garanton lidhje të ngushtë midis përdorimit të asistencës IPA dhe procesit të përgjithshëm të anëtarësimit;
 - b) merr masa për të siguruar që objektivat e vendosur në programet e veprimit, për të cilët janë besuar detyrat e zbatimit të buxhetit, të jenë adresuar siç duhet gjatë zbatimit të asistencës IPARD III;
 - c) në zbatim të nenit 57 të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, koordinon hartimin e një plani vlerësimi, në konsultim me Komisionin, ku paraqet aktivitetet vlerësuese, që kryhen në faza të ndryshme të zbatimit të asistencës së programeve IPA III dhe IPARD III, duke përfshirë në këtë plan edhe planin e vlerësimit të hartuar nga AM-ja, në konsultim me KKIPA-në, për programin IPARD III;
 - ç) bën të gjitha përpjekjet që administrata shtetërore të marrë masat e duhura për të lehtësuar zbatimin e programeve përkatëse;
 - d) siguron që objektivat e vendosur në veprimet apo programet e propozuara nga administrata shtetërore të jenë në koherencë me objektivat e përcaktuar në Dokumentin Kombëtar Strategjik;
 - dh) merr masat për të siguruar pronësinë e programimit dhe implementimit të asistencës së IPARD III nga qeveria shqiptare;
 - e) merr pjesë, pa të drejtë vote, në Komitetin Monitorues IPARD III;
 - ë) i paraqet Komisionit raportet vjetore dhe ato finale implementuese, të hartuara nga AM-ja dhe të miratuara nga Komiteti Monitorues IPARD III, duke vënë në dijeni edhe ZKA-në dhe AA-në;
 - f) konfirmon, së bashku me ZKA-në dhe titullarin e autoritetit auditues, gatishmërinë për të realizuar funksionet dhe përgjegjësitë që u janë ngarkuar, sipas shtojcës A të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit;
 - g) brenda datës 15 shkurt, të vitit financiar pasardhës, i dorëzon Komisionit një raport vjetor

¹ Neni 6, pika 1, i marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit për IPA III.

mbi zbatimin e asistencës IPA III, programit IPARD III dhe detyrave të besuara për zbatimin e buxhetit, sipas neneve 59 e 60 të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit për IPA III.

IV. ZYRTARI KOMBËTAR AUTORIZUES (ZKA)

1. Zyrtari Kombëtar Autorizues është zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë.
2. ZKA-ja është përgjegjës për menaxhimin financiar të asistencës së IPA III dhe IPARD III në Shqipëri dhe për ligjshmërinë e rregullsinë e shpenzimeve.
3. Në fushën e menaxhimit financiar, ZKA-ja kryen këto detyra:
 - a) Ngre një sistem kontabël aktual për regjistrimin dhe ruajtjen në format elektronik të të dhënave kontabël të sakta, të plota dhe të besueshme për programin IPARD III që zbatohet me menaxhim indirekt nga Shqipëria;
 - b) Organizon dhe menaxhon sistemin e llogarive në euro;
 - c) Dërgon pranë Komisionit kërkesëpagesat për programin IPARD III;
 - ç) Garanton ekzistencën, korrektësinë dhe disponueshmërinë e elementeve të bashkëfinancimit;
 - d) Përcjell pranë Agjencisë IPARD fondet që merr nga Komisioni dhe bashkëfinancimi publik për menaxhim financiar për transferim të mëtijshëm të marrësit të asistencës së IPARD III;
 - dh) Garanton ekzistencën dhe disponueshmërinë e burimeve të mjaftueshme për të përballuar mungesat e mundshme, për shkak të transferimit me vonesë të fondeve nga Komisioni ose urdhrave të rikuperimit që nxjerr Komisioni.
4. ZKA-ja ka përgjegjësinë e plotë për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të IPA III dhe IPARD III në Shqipëri:
 - a) duke aplikuar dhe dorëzuar pranë Komisionit kërkesën për të marrë detyrat e zbatimit të buxhetit, në kuadrin e një programi apo mase të caktuar, në përputhje me nenet 13(1) dhe 13(2), të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, dhe nenit 26 të marrëveshjes sektoriale, të ratifikuar me ligjin nr. 97/2022;
 - b) duke monitoruar përmbushjen në vijimësi nga ana e strukturave dhe autoriteteve të kërkesave të neneve 12(2) dhe 12(3) dhe të shtojcës B të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, dhe të shtojcës B të marrëveshjes sektoriale, ratifikuar me ligjin nr. 97/2022, si dhe informon Komisionin, duke vënë në dijeni KKIPA-në dhe autoritetin auditues për çdo mospërmbushje të këtyre kërkesave,;
 - c) duke vendosur masat efektive dhe antimashtim, duke marrë parasysh risqet e identifikuara;
 - ç) duke marrë parasysh rezultatet e të gjitha verifikimeve dhe auditeve të jashtme lidhur me sistemin e menaxhimit dhe kontrollit IPARD III, përfshirë ato të kryera nga autoriteti auditues, Komisioni apo Gjykata Evropiane e Llogarive, si dhe duke koordinuar përgatitjen dhe zbatimin e planeve përkatëse të veprimit, me qëllim përmirësimin e përputhshmërisë dhe efektivitetit të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit IPARD III;
 - d) duke vendosur dhe miratuar rregullat e procedurat, nëpërmjet marrëveshjes zbatuese dhe operacionale me KKIPA-në, autoritetin menaxhues IPARD dhe agjencinë IPARD.
5. ZKA-ja harton dhe dorëzon, pranë Komisionit, duke vënë në dijeni KKIPA-në dhe autoritetin auditues, deri në 15 shkurt të vitit financiar pasardhës, dokumentacionin, sipas kërkesave të parashikuara në pikën 2, të nenit 61, të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit.
6. ZKA-ja vepron si bashkëbiseduesi i vetëm me KE-në për të gjitha çështjet mbi IPARD III, sipas përcaktimeve të nenit 7 të marrëveshjes sektoriale.
7. ZKA-ja bashkëpunon me strukturën e inspektimit financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, që vepron si Njësia e Shërbimit të Koordinimit Kundër Mashtrimit (AFCOS), me qëllim parandalimin, zbulimin, raportimin, investigimin dhe ndjekjen e parregullsive. Marrëdhëniet e ndërsjella rregullohen me memorandumet e bashkëpunimit, ndërmjet ZKA-së dhe strukturës së inspektimit financiar (AFCOS) dhe ndërmjet ZKA-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Shqipërisë.
8. Garanton hetim dhe trajtim efektiv të rasteve të dyshuara për parregullsi, mashtrim,

korupsion dhe konflikt interesi gjatë zbatimit, si dhe funksionimin e një mekanizmi kontrolli dhe raportimi për to, në përputhje me nenin 51(2), (3) dhe (4) të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit.

9. ZKA-ja miraton manualin e procedurave për strukturën menaxhuese dhe zbatuese dhe marrëveshjet ndërmjet autoriteteve.

10. ZKA-ja vlerëson çdo ndryshim të propozuar në procedurat e autoritetit menaxhues IPARD/Agjencisë IPARD dhe SM-së, për zbatimin apo kryerjen e pagesave. ZKA-ja informon KE-në, duke vënë në dijeni edhe AA-në për çdo ndryshim thelbësor, duke përfshirë edhe vlerësimin e tij, shpjegimet e duhura, arsyetimet dhe dokumentet mbështetëse të nevojshme për shqyrtim e miratim paraprak për zbatimin e ndryshimeve.

V. STRUKTURA MENAXHUESE

1. Struktura menaxhuese përbëhet nga organi kontabël dhe zyra mbështetëse e ZKA-së, struktura të veçanta në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nën përgjegjësinë e ZKA-së për zbatimin e programit IPARD III, me një ndarje të qartë të detyrave, siç përshkruhet në këtë vendim, në manualin e tyre të procedurave dhe rregulloren e brendshme të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Organi kontabël është strukturë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, që ka kompetenca qendrore buxhetore dhe vepron si subjekt qendror i thesarit. Ai mbështet ZKA-në në përmbushjen e detyrave të tij/saj, në veçanti, ato të menaxhimit të llogarive të IPA III dhe IPARD III, dhe në operacionet financiare, dhe është përgjegjës për detyrat e menaxhimit financiar të asistencës IPARD III, nën përgjegjësinë e ZKA-së.

3. Organi kontabël mbështet ZKA-në në realizimin e detyrave në përputhje me shtojcën A, klauzola 4(3) dhe nenin 61(5), të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit. Organi kontabël është veçanërisht përgjegjës, për:

- a) hapjen dhe organizimin e llogarive bankare të IPARD III;
- b) kërkimin e fondeve dhe marrjen e të gjitha pagesave nga buxheti i BE-së;
- c) kërkimin e fondeve dhe marrjen e të gjitha pagesave nga buxheti i shtetit, për elementet e bashkëfinancimit, sipas rastit;
- ç) autorizimin dhe transferimin e këtyre pagesave tek Agjencia IPARD ose te marrësit;
- d) kthimin e fondeve në buxhetin e BE-së, pas lëshimit të urdhrave të kthimit nga Komisioni;
- dh) mbështetjen e ZKA-së në përgatitjen e raportimit financiar për Komisionin dhe mbajtjen e një sistemi kontabël kompjuterik, që jep informacion të saktë, të plotë, të besueshëm dhe në kohën e duhur.

4. Gjatë përmbushjes së përgjegjësisë të tij lidhur me menaxhimin financiar të IPA III, organi kontabël bashkëpunon me Bankën e Shqipërisë, bazuar në një marrëveshje të posaçme, që rregullon afatet dhe kushtet për funksionimin e llogarive në monedhën vendëse dhe të huaj, të hapura me Bankën e Shqipërisë.

5. Kur është e nevojshme, organi kontabël kryen verifikime në vend, për të siguruar menaxhim efektiv dhe efikas financiar të llogarive IPARD III dhe të operacioneve financiare.

6. Zyra mbështetëse e ZKA-së është strukturë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nën përgjegjësinë dhe në raportim direkt me ZKA-në, në mbështetje të përmbushjes së përgjegjësisë të tij/saj për funksionimin efektiv të menaxhimit dhe të sistemeve të kontrollit të brendshëm, për zbatimin e asistencës së programit IPARD III.

7. Zyra mbështetëse e ZKA-së mbështet ZKA-në në realizimin e detyrave, në përputhje me shtojcën A, klauzolën 4(2) të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit. Zyra mbështetëse e ZKA-së është veçanërisht përgjegjëse, për:

a) garantimin dhe sigurimin e ZKA-së për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve themeltare;

b) vendosjen e masave efikase dhe antimashttrim, duke marrë parasysh risqet e identifikuar, garantimin e raportimit, sipas dispozitave të pikës 2, të nenit 51, të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, të ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, duke koordinuar me shërbimet e strukturës së

inspektimit financiar (AFCOS) dhe duke informuar në lidhje me këtë raportim;

c) monitorimin dhe përmbushjen në vijimësi nga struktura menaxhuese dhe autoriteti menaxhues IPARD e agjencia IPARD të kërkesave të neneve 12(2) dhe 12(3) dhe shtojcës B, të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, për informimin pa vonesë të Komisionit, në rast mosplotësimi të tyre, si dhe për marrjen e masave mbrojtëse, të përshtatshme, në lidhje me pagesat e kryera ose kontratat e nënshkruara;

ç) ngritjen dhe sigurimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm efektiv dhe efikas, duke marrë parasysh:

- i. mjedisin e kontrollit;
- ii. menaxhimin e riskut;
- iii. aktivitetet e kontrollit;
- iv. informimin dhe komunikimin;
- v. monitorimin e kuadrit të kontrollit të brendshëm;

d) sigurimin e raportimit mbi sistemet e menaxhimit e kontrollit dhe vlerësimin e kapaciteteve të stafit për programim e zbatim në strukturat menaxhuese dhe operative, të përfshira në procedurat e programimit dhe zbatimit;

dh) sigurimin e funksionimit të një sistemi të përshtatshëm raportimi dhe informimi;

e) ndjekjen e konstatimeve dhe rekomandimeve të raporteve të auditit, të kryera nga Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës së Bashkimit Evropian, dhe sigurimin e informacionit të vazhdueshëm për ZKA-në, me qëllim marrjen e vendimeve;

ë) mbajtjen parasysh, gjatë përgatitjes së deklaratës vjetore të menaxhimit, siç parashikohet në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 61, të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, të ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, të rezultateve të auditeve të kryera nga/nën përgjegjësinë e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës së Bashkimit Evropian;

f) njoftimin menjëherë, pranë Komisionit, për ndonjë ndryshim thelbësor, në lidhje me sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit për shqyrtimin e miratimit paraprak të zbatimit të tyre;

g) bashkërendimin e aktiviteteve të IPARD III, për llogari të ZKA-së dhe, kur është e nevojshme, përgatitjen e planeve të veprimit të konsoliduara, duke adresuar dobësitë e identifikuara në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit;

gj) në përputhje me planin vjetor të vizitave verifikuese e menaxheriale, kur është e nevojshme, kryerjen e verifikimeve në vend, për të siguruar funksionimin efektiv të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm.

8. Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës Financiare nga Bashkimi Evropian është një strukturë e pavarur, funksionale dhe financiare, nga strukturat dhe autoritetet e cituara në pikën 2, të këtij vendimi. Funksionet dhe përgjegjësitë e saj përcaktohen me ligj dhe me vendim të Këshillit të Ministrave.

VI. STRUKTURAT PËR PROGRAMET E ZHVILLIMIT RURAL

1. Autoriteti menaxhues IPARD dhe agjencia IPARD janë strukturat për programet e zhvillimit rural, të pavarura nga njëra-tjetra, por që funksionojnë në bashkëpunim të ngushtë.

2. Detyrat specifike të autoritetit menaxhues IPARD dhe agjencisë IPARD përcaktohen në kërret VII dhe VIII të këtij vendimi dhe rregullohen me një marrëveshje operationale ndërmjet tyre.

VII. AUTORITETI MENAXHUES IPARD

1. Autoriteti menaxhues IPARD është strukturë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e programeve, përfshirë përzgjedhjen e masave dhe publicitetin, koordinimin, vlerësimin, monitorimin e raportimin e programit IPARD III.

2. Autoriteti menaxhues IPARD kryen funksionet, duke siguruar zbatim efektiv të programit IPARD III, për:

a) përgatitjen e programit IPARD III dhe të ndryshimeve të mundshme të tij, përfshirë ato që kërkojnë nga Komisioni;

b) kontrollin dhe verifikimin e masave që përcaktohen në programin IPARD III, në

bashkëpunim me agjencinë IPARD;

c) përzgjedhjen e masave, nën secilën thirrje për aplikim, në kuadrin e programit IPARD III, kohën e zbatimit, kushtet e pranimit dhe shpërndarjen financiare për çdo masë, nën çdo thirrje. Vendimet merren bashkërisht me agjencinë IPARD;

ç) miratimin e bazës ligjore kombëtare të përshtatshme për zbatimin e IPARD III, si dhe rishikimin e saj, sipas nevojës;

d) mbështetjen e Komitetit Monitorues IPARD III, kryesisht duke ofruar dokumentet e nevojshme për monitorimin e cilësisë dhe zbatimit të programit IPARD III.

3. Autoriteti menaxhues IPARD ngre një sistem raportimi dhe informimi për mbledhjen e informacionit financiar dhe statistikor mbi progresin e programit IPARD III, bazuar edhe në informacionin që merr nga agjencia IPARD. Këto të dhëna AM-ja ia përcjell Komitetit Monitorues IPARD III, sipas modaliteteve të rëna dakord ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit, duke përdorur, ku është e mundur, sisteme kompjuterike që mundësojnë shkëmbim të dhënash me të dhe të lidhura me sistemin e raportimit e informacionit të ngritur nga ZKA-ja, në përputhje me pikën 4, të klauzolës 6a, të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit.

4. Autoriteti menaxhues IPARD i propozon Komisionit ndryshime në programin IPARD III, duke vënë në dijeni edhe Koordinatorin Kombëtar IPA, pas konsultimit me agjencinë IPARD dhe pasi ka marrë pëlqimin e Komitetit Monitorues IPARD III. Autoriteti menaxhues IPARD është përgjegjës për informimin e autoriteteve përkatëse mbi nevojën e ndryshimeve administrative, kur këto ndryshime kërkohen pas një vendimi të Komisionit që ndryshon programin IPARD III.

5. Autoriteti menaxhues IPARD harton çdo vit një plan veprimi për operacionet që synohen të realizohen me asistencën teknike, i cili i dorëzohet Komitetit Monitorues IPARD III për miratim.

6. Autoriteti menaxhues IPARD harton një plan vlerësimi, i cili i dorëzohet Komitetit Monitorues, jo më vonë se një vit pas miratimit të programit IPARD III nga Komisioni. Autoriteti menaxhues IPARD raporton te Komiteti Monitorues IPARD III dhe te Komisioni mbi progresin e bërë me zbatimin e këtij plani.

7. Autoriteti menaxhues IPARD harton një plan koherent me aktivitetet për vizibilitetin dhe komunikimin, si dhe konsultohet e informon Komisionin, pasi është këshilluar me Komitetin Monitorues IPARD III. Plani, mbi të gjitha, tregon nismat e ndërmarra dhe që do të ndërmerren për informimin e publikut për rolin e luajtur nga BE-ja e programi IPARD III dhe për rezultatet e tij.

8. Nëse autoriteti menaxhues IPARD delegon një pjesë të detyrave te një organ tjetër, ai mban përgjegjësinë e plotë për menaxhimin dhe zbatimin e atyre detyrave, në përputhje me parimin e menaxhimit të shëndoshë financiar.

9. Autoriteti menaxhues IPARD siguron që të gjitha informacionet përkatëse në lidhje me ecurinë e masave t'i vihen në dispozicion Komitetit Monitorues të programit IPARD III dhe KKIPA-së.

VIII. AGJENCIA IPARD

1. Agjencia IPARD është një agjenci e pavarur, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përgjegjëse për zbatimin e programit IPARD III, raportimin, autorizimin dhe kontrollin e detyrimeve financiare, autorizimin dhe kontrollin e pagesave, ekzekutimin e pagesave, kontabilizimin e detyrimeve dhe pagesave, menaxhimin e borxhit, thesarit, përzgjedhjen e projekteve, publicitetin dhe auditimin e brendshëm.

2. Agjencia IPARD është përgjegjëse, për:

a) dhënien e konfirmimit autoritetit menaxhues për kontrollin dhe verifikimin e masave të programit IPARD III;

b) organizimin e thirrjeve për aplikime dhe publikimin e kushteve e të pranueshmërisë, pasi merr pëlqimin e autoritetit menaxhues IPARD lidhur me çështjet e ngritura në klauzolat 6a(3)(c) të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit;

- c) përzgjedhjen e projekteve për zbatim;
- ç) përcaktimin me shkrim të detyrimeve kontraktuale, ndërmjet agjencisë IPARD dhe përfituesve, përfshirë informacionin për sanksionet e mundshme, në rast mospërmbushjeje të detyrave dhe, sipas rastit, lëshimin e miratimit për nisjen e punës. Agjencia IPARD mund të vazhdojë të kontraktojë apo të marrë përsipër zotime, në zbatim të kësaj marrëveshjeje për një masë specifike, deri në datën kur Shqipëria fillon të kontraktojë apo të marrë përsipër zotime për këtë masë, në kuadrin e ndonjë programi pasues të IPARD III;
- d) marrjen e masave ndjekëse për të garantuar progresin e projekteve në zbatim;
- dh) raportimin mbi progresin e masave në zbatim, kundrejt disa indikatorëve;
- e) garantimin që përfituesi të sensibilizohet për kontributin e BE-së në projekt;
- ë) garantimin për raportimin e parregullsive, në nivel kombëtar;
- f) garantimin që ZKA-ja, struktura menaxhuese dhe autoriteti menaxhues IPARD të marrin të gjithë informacionin që u nevojitet për kryerjen e detyrave të tyre;
- g) garantimin e respektimit të detyrimeve në lidhje me publicitetin, sipas nenit 23, të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit.

3. Për investime në projekte infrastrukturore, që priten të gjenerojnë të ardhura neto të konsiderueshme, agjencia IPARD vlerëson nëse ky projekt është i këtij tipi para se të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me një përfitues potencial. Nëse konstatohet se ai është i tillë, agjencia IPARD sigurohet që ndihma publike nga të gjitha burimet nuk tejkalon masën 50% të koston totale të lidhur me projektin dhe të konsideruar të pranueshme për bashkëfinancim të BE-së.

4. Agjencia IPARD siguron që për çdo projekt të programit IPARD III, akumulimi i ndihmës publike, të dhënë nga të gjitha burimet, të mos tejkalojë tavanet maksimale për shpenzimet publike, të përcaktuara në shtojcën 4, të marrëveshjes sektoriale.

IX. KOMITETI I MONITORIMIT PËR PROGRAMIN IPARD III

1. Autoriteti menaxhues dhe Komiteti i Monitorimit të programit IPARD III (këtu e në vijim “Komiteti i Monitorimit”) monitoron efektivitetin dhe cilësinë e zbatimit të programit IPARD III.

2. Komiteti i Monitorimit themelohet pas miratimit të programit dhe kryesohet nga një përfaqësues i lartë i Shqipërisë, i cili ka të drejtë vote dhe raporton pranë Komitetit Monitorues të IPA III dhe KE-së për progresin e masave.

3. Komisioni, autoriteti menaxhues IPARD/Agjencia IPARD, ZKA-ja dhe KKIPA-ja marrin pjesë, pa të drejtë vote, në punën e Komitetit Monitorues IPARD III. Me qëllim zbatimin e pikës 1, të nenit 53, të marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit, Komiteti i Monitorimit shqyrton rezultatet e programit IPARD III, në veçanti arritjen e objektivave të përcaktuar për masat e ndryshme dhe ecurinë e alokimeve financiare ndaj këtyre masave. Në këtë drejtim, autoriteti menaxhues IPARD garanton që i gjithë informacioni lidhur me ecurinë e masave t’i vihet në dispozicion Komitetit Monitorues dhe KKIPA-së.

4. Komiteti i Monitorimit shqyrton, periodikisht, progresin e bërë drejt arritjes së objektivave të përcaktuar në programin IPARD III. Për këtë qëllim, Komitetit duhet t’i vihen në dispozicion, veçanërisht, informacioni për çdo sektor ose masë, ku janë hasur vështirësi, si dhe mbi rezultatet e verifikimeve të realizuara.

5. Komiteti i Monitorimit duhet të marrë në konsideratë dhe të miratojë, kur është e përshtatshme, çdo propozim për ndryshim të programit IPARD III, të hartuar nga AM-a, për t’iu dërguar KE-së dhe, për dijeni, KKIPA-së e ZKA-së.

6. Komiteti i Monitorimit, pas konsultimit me autoritetin menaxhues IPARD dhe agjencinë IPARD, i propozon autoritetit menaxhues IPARD, duke vënë në dijeni ZKA-në dhe KKIPA-në, ndryshime për programin IPARD III, me qëllim arritjen e objektivave dhe rritjen e asistencës së dhënë.

7. Komiteti i Monitorimit shqyrton dhe miraton raportet vjetore e përfundimtare të zbatimit, përpara se ato të dërgohen pranë KKIPA-së për dorëzimin në KE, me një kopje për ZKA-në dhe autoritetin auditues.

8. Komiteti i Monitorimit shqyrton vlerësimet e programit IPARD III, referuar nenit 56 të marrëveshjes sektoriale.

9. Komiteti i Monitorimit shqyrton dhe miraton planin me aktivitetet e vizibilitetit dhe komunikimit, të përcaktuara në nenin 32 të marrëveshjes sektoriale, si dhe çdo përditësim të mëvonshëm të tij.

10. Për aktivitetet e asistencës teknike, në kuadrin e programit IPARD III, merret mendimi i Komitetit të Monitorimit. Ai shqyrton dhe miraton çdo vit një plan veprimi vjetor, tregues për zbatimin e aktiviteteve të asistencës teknike, bashkë me shumat indikative, për qëllime informimi.

11. Komiteti i Monitorimit vepron në përputhje me rrethanat, nëse nga programi IPARD III i kërkohet të japë mendim për ndonjë çështje.

12. Të gjitha dokumentet përfundimtare të mbledhjeve të Komitetit të Monitorimit bëhen publike.

X. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama